



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Zyra e Kryeministrit –Ured Premijera –Office of the Prime Minister

Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija za Statistiku Kosova - Kosovo Agency of Statistics

Bazuar në nenin 8 pika 3.1, nenit 6 pika 5 dhe nenit 33 të Ligjit Nr.04/L-036 për Statistikat Zyrtare të Republikës së Kosovës, Udhëzimit Administrativ Nr.08/2012 për kushtet dhe Mënyrën e Ofrimit të të Dhënave të Fituara me Përpunime të Veçanta të Statistikave Zyrtare si dhe nenit 12 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 03/ L -149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligjin Nr. 04/L-077 Për Marrëdhëniet e Detyrimeve, **Agjencia e Statistikave të Kosovës**, bënë:

Shpallje të Konkursit Publik për Marrëveshje për Shërbime të Veçanta

Emri i Institucionit	<i>Agjencia e Statistikave të Kosovës</i>
Titulli i punës:	Mbikqyrës për Projektin e Ekonomisë informale në biznese
Numri i referencës:	ASK-DSLLK-001
Tarifa e shërbimit:	500 Euro (Bruto)
Raporton te:	Menaxheri i projektit
Lloji i kontratës:	Marrëveshje për shërbime të veçanta
Kohëzgjatja e kontratës:	2 muaj
Orari i punës:	I plotë
Lokacioni dhe numri i ekzekutuesve:	ASK-2

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Mbikëqyrë dhe monitoron procesin e mbledhjes së të dhënave në terren nga kompania dhe raporton në baza ditore tek menaxheri i NOE
- Ofron instruksione shtesë lidhur me metodologjinë e mbledhjes së të dhënave në terren sipas nevojës
- Siguron mbështetje administrative dhe teknike për ekipin menaxhues të projektit të NOE duke përfshirë përgatitjen e raporteve ditore mbi rrjedhën e punës në terren
- Përgatitë kopjet fizike të dokumenteve dhe dosjeve të menaxherit të projektit të NOE sipas nevojës

- Kryen detyra të tjera për projektin e NOE dhe koordinon aktivitete të ndryshme që lidhen me projektin e NOE
- Dorëzon raportet tek menaxheri i projektit të NOE për punët tjera që jepen nga menaxheri

Shkathësitë e kërkuara:

Përgatitja universitare: Diplomë fakulteti në ekonomi

Përvoja e punës: E preferueshme përvoja e punës në detyra të ngjashme

Kompetencat dhe aftësitë:

- Njohuri të duhur profesionale në fushën e statistikave
- Shkathësi kompjuterike në aplikacione të programeve (Word, Excel, Access);
- Aftësi për të koordinuar dhe mbikëqyrë proceset e punës në nivelin administrativ dhe teknik
- Përvojë në përgatitjen e raporteve
- Njohuri të Gjuhës Angleze (posaqërisht në të shkruar)
- Aftësi të mira komunikimi

Agjencia e Statistikave të Kosovës mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore, nga të gjitha komunitetet.

Kushtet e pjesëmarrjes në konkurs:

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë Qytetarët e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, janë në posedim të të drejtave civile dhe politike, kanë përgatitjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave dhe të cilët kanë aftësitë fizike që kërkohen për pozitën përkatëse.

Konkursi është i hapur 8 ditë kalendarike nga dita e publikimit në mjetet e informimit dhe në ueb faqen e ASK-se.

Paraqitja e kërkesave: Formularët për aplikim mund të merren në Arhivën e ASK-së, ose mund të tërhiqen nga web faqja e ASK-së në adresën <http://ask.rks-gov.net/>. Aplikacionet merren dhe dorëzohen në Agjencinë e Statistikave të Kosovës, Rr. "Zenel Salihu" nr.4 Prishtinë.

Aplikacionit duhet t'i bashkangjiten: Kopja e letërnjoftimit, kopjet e dokumentacionit të kualifikimit, si dhe dokumentacionet tjera të nevojshme sipas konkursit.

Kërkesat e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen. Kërkesat e pakompletuara do të refuzohen.

Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.

Për informata të hollësishme, mund të kontaktoni në zyrën e personelit, në tel: 038- 20031149, prej orës 08:00 - 16: 00.